



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD U PRISTINI – BASIC CORT OF PRISTINA



DEGA NË LIPJAN – OGRANAK U LIPLJANU

P.nr.23/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm Avdirrahman Gashi, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Drita Llugiqi, në çështjen penale ndaj të pandehurve Xh. S. nga fsh. S. K. L., dhe A. S. nga fsh. S. K. L., të cilët i akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.8056/17 të dt. 11.01.2018, për të pandehurin e I. për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par. 2 të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin e II. për shkak të veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë i paraparë dhe sanksionuar me nenin 333 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e PTH-Prishtinë, për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës gjyqësore, me dt. 15.02.2018 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-së në Prishtinë, PP.II.nr.8056/2017 të dt.11.01.2018, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

Ndaj të pandehurve:

I.Xh. S., nga i ati M., dhe e ëma H., e gjinisë G., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në fsh. S. K. L., ku edhe jeton, me nr. personal nr. *numri përsonal...*, i pa punë, i martuar, ka të kryer katër klasë të shkollës fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II.A. S., nga i ati F., dhe e ëma H., e gjinisë G., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në fsh. S. K. L., ku edhe jeton, me nr. personal *numri përsonal...*, i martuar, punëtor ndërtimtarie, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

J A N Ë F A J T O R

Sepse:

I.I pandehuri **Xh. S.**

Me dt. 25.12.2017, rreth orës 16:00, në fshatin S. Komuna e L., me dashje dhe me qëllim të friksimit ka kanosur të dëmtuarën H. S., duke i shkaktuar ankth dhe frikë, në atë mënyrë që ditën kritike, duke qenë familjarë mes veti dhe duke pasur mosmarrëveshje për çështje pronësore, i pandehuri ka hyrë në oborrin e shtëpisë së gruas së xhaxhait – të dëmtuarës H. S. dhe me një revole plastike në dorë e ka kërcënuar të dëmtuarën me fjalët “krejtve ka me ju vra që mi keni nxerr pishat” dhe ishte larguar nga vendi i ngjarjes,-

]

-me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 185 par. 2 të KPRK-së.

II.I pandehuri **A. S**

Me dt. 25.12.2017, rreth orës 16:30 në fsh.S. Komuna e L., me dashje dhe me qëllim e dëmton pasurinë – makinë të pandehurit të parë Xh. S.- këtu i dëmtuar, në atë mënyrë që ditën e incidentit gjersa gjendej në qytetin e Lipjanit ishte njoftuar nga nëna e tij H. S. se i pandehuri i parë e kishte kërcënuar, ky menjëherë e kishte njoftuar policinë dhe urgjent kishte shkuar në S. tek shtëpia e tij, kur kishte arritur aty e kishte parë makinën e të pandehurit të parë të parkuar në rrugë, në atë qastë me veturën e tij të tipit “Audi 80” e ka goditur veturën e të pandehurit të parë të tipit “Opel Vectra” me ngjyrë të bardhë, duke e shtyrë zhag rreth 20 metra deri tek rruga kryesore, me ç’ka i ka shkaktuar dëme materiale,-

-me këtë, ka kryer veprën penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë, e paraparë dhe sanksionuar me nenin 333 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata, konform neneve, 1, 2, 4, 6, 17, 23, 41, 42, 43, 46, 73, 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe nenet 493, 495 dhe 365 të KPPK-së, të pandehurit i gjykon me,

DËNIM ME GJOBË

I.Të pandehurin Xh. S., e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej **250- € (dyqindpesëdhjetëeuro)**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.Të pandehurin A. S., e gjykon me dënim me gjobë në shumë prej **250- € (dyqindpesëdhjetëeuro)**, të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj, në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konform nenit 46 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€.

E dëmtuara: H. S. nga fsh. S. K. Lipjan, udhëzohet që kërkesën pasurore-juridike ta realizoj në procedurë të rregullt gjyqësore.

DETYROHEN: të akuzuarit që në emër të shpenzimeve për paushall gjyqësor, kësaj gjykate t’ia paguajnë secili veç e veç shumën nga 20-€, dhe sicili nga 30.-€ për Fondin e mbrojtjes së Viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me aktakuzën e saj, PP.II.nr.8056/17 të dt.11.01.2018, i ka akuzuar të pandehurit, Xh. S. dhe A. S. që të dy nga fsh. S. K. L., ku të pandehurin e parë Xh. S. për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 185 par. 2 të KPRK-së, kurse të pandehurin e dytë A. S. për shkak të veprës penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par. 1 të KPRK-së, dhe njëkohësisht ka kërkuar që ndaj të njëjtëve të shqiptohet urdhri ndëshkimor-dënimimi me gjobë për veprat e lartcekura penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi shqyrtoi provat që janë bashkangjitur aktakuzës respektivisht kallëzimit penal me nr. 2017-AH-1343 të dt. 25.12.2017, Raportin e policit hetues të dt. 25.12.2017, Procesverbalin mbi intervistimin e të dëmtuares të dt. 25.12.2017, Procesverbalin mbi intervistimin e të pandehurit te parë i dt. 25.12.2017, Procesverbalin mbi intervistimin e të pandehurit të dytë i dt. 25.12.2017, si dhe foto

] dokumentacioni dhe shkresat tjera të lëndës, erdhi në përfundim se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës në drejtim të vërtetimit të fakteve se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen, andaj kjo gjykatë të njëjtit i shpalli fajtor dhe i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitën e nenit 493 të KPPK-së parashihet se “Për vepra penale e cila parashihet dënimi me gjobë ose burgim deri në 3 (tre) vite, për të cilat prokurori i shtetit është i informuar me provat e besueshme nga kallëzimi penal, prokurori i shtetit mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhrë ndëshkimor, në të cilin të akuzuarit do ti shqiptoi dënim përkatës pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor”.

Gjyqtari me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes konform nenit 493 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për shqiptimin e urdhrë ndëshkimor ndaj të akuzuarve nga arsyet se dënimi për veprat penale me të cilën ngarkohen të akuzuarit janë dënime me gjobë apo me burgim deri në 3 (tre) vite, andaj gjykata konform dispozitave të lartcekura vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me dënimet e shqiptuara do të arrihet qëllimi i dënimet i paraparë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u bazua konform nenit 450 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së, duke marr për bazë ndërlikushmërinë e rastit ndërsa shuma prej 30.-€ që duhet paguar në Fondin e Viktimave të krimit u bazua në Qarkoren e Gjykatës Supreme të Kosovës nr.35/20018 e datës 30.01.2018.

Vendimi për kërkesën pasurore- juridike, të dëmtuarit u bazua konform nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- DEGA NË LIPJAN

P.nr.23/18, me dt. 15.02.2018

G J Y Q T A R I

Avdirrahman Gashi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej 8 (tetë) dite nga dita e dorëzimit së të njëjtit. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate.